REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 2539/6 prot. Tiranë, më 28.10.2026

V E N D I M

Nr. 46, datë 28.10.2026

PËR

ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 4, 5, 6 dhe 7, pikës 1 dhe shkronjave "c", "dh", "e" dhe "f" të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit"), në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026", në përmbushje të Programit të Punës për vitin 2026, si dhe referuar Planit të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive për vitin 2026, ka kryer verifikimin e përmbushjes së detyrimeve lidhur me publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin Institucional të Transparencës së Autoritetit Publik "Bashkia Këlcyrë" (në vijim "Autoriteti Publik").

Autoriteti Publik i ushtron kompetencat e tij bazuar në dispozitat e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar. Në pikën 1 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar (në vijim "LDI"), përcaktohet se: *""Autoritet publik": a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli,* ***organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli****, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare, ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike".* Për rrjedhojë, Bashkia Këlcyrë konsiderohet autoritet publik në kuptim të LDI-së dhe, si e tillë, i nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, përfshirë ato që lidhen me transparencën proaktive dhe publikimin e informacionit pa kërkesë.

Në pikën 1 të nenit 4 të LDI-së parashikohet se: *"Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni".* Në pikën 3 të nenit 4 të LDI-së përcaktohet se: *"Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik".* Ndërsa, në nenin 6 të LDI-së parashikohet se: *"Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike..."*.

Neni 8 i LDI-së përcakton se: *"1. Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër. 2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit".*

Bazuar në nenin 6 të LDI-së, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") ka miratuar Urdhrin nr. 281, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore" (në vijim "Urdhri nr. 281/2025"), publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 6, datë 08.01.2026.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 8 të LDI-së, Komisioneri ka miratuar Urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020 "Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar" (në vijim "Urdhri nr. 188/2020"), publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 224, datë 22.12.2020.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive të Autoriteteve Publike për vitin 2026, miratuar me shkresën nr. 630 prot., datë 27.02.2026, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë Autoritetit Publik Urdhrin nr. 177, datë 10.09.2026 "Për kryerjen e hetimit administrativ", me objekt verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore, që lidhen me:

- *Përmbushjen e detyrimit për vënien në dispozicion të publikut në faqet e tyre në internet të kategorive të informacionit, që bëhen publike pa kërkesë, referuar nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.*
- *Përmbushjen e detyrimit për vënien në zbatim të Programit Institucional të Transparencës sipas Urdhrit nr. 281/2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore".*
- *Përmbushjen e detyrimit për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit, referuar pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.*
- *Përmbushjen e detyrimit për krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar nenit 8 dhe shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, si dhe Urdhrit*

nr.188/2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar".

Më datë 17.09.2026, grupi i punës i Zyrës së Komisionerit u paraqit në ambientet e Autoritetit Publik për zhvillimin e hetimit administrativ, i cili i është njoftuar paraprakisht edhe nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 15.09.2026. Gjatë hetimit administrativ u paraqitën përfaqësuesit e Autoritetit Publik, z. Klement Ndoni, Kryetar i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e personit përgjegjës për Programin e Transparencës, si dhe z. Orlando Hadaj, me detyrë përgjegjës në Zyrën e Emergjencat Civile, njëkohësisht i caktuar edhe si koordinator për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, në cilësinë e personit përgjegjës për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Nga verifikimet e kryera, grupi i punës konstatoi se Autoriteti Publik nuk kishte publikuar Programin Institucional të Transparencës sipas modelit të miratuar me Urdhrin nr. 281/2025 dhe nuk kishte përmbushur detyrimin për publikimin dhe përditësimin e informacionit në rubrikat përkatëse, në përputhje me nenin 7 të LDI-së. Gjithashtu, u konstatua se nuk ishte publikuar dhe përditësuar regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, referuar nenit 8 të LDI-së dhe Urdhrit nr. 188/2020. Përfaqësuesit e Autoritetit Publik shprehën gatishmërinë e tyre për angazhimin e plotë lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore të sipërpërmendura, brenda një afati të arsyeshëm. Sipas procesverbalit, Autoritetit Publik iu la afat për përmbushjen e detyrimeve deri në datën 02.10.2026. Në datën 21.09.2026, Zyrës së Komisionerit iu përcoll nëpërmjet komunikimit elektronik regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve të Bashkisë Këlcyrë, për vitin 2026, referuar detyrave të lëna në procesverbalin e kryerjes së hetimit administrativ, por rezulton se nuk është publikuar në rubrikën përkatëse në faqen zyrtare.

Pas përfundimit të afatit të lënë për korrigjimin e mangësive, Zyra e Komisionerit monitoroi *online* faqen zyrtare të Autoritetit Publik, më datë 06.10.2026. Nga verifikimi rezultoi se Autoriteti Publik vijonte të ishte në mospërmbushje të detyrimit për publikimin dhe përditësimin me informacion në rubrikat e Programit Institucional të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe Urdhrin nr. 281/2025.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore, nëpërmjet shkresës nr. 2539/4 prot., datë 06.10.2026, e caktuar për t'u mbajtur në datën 14.10.2026, me qëllim garantimin e së drejtës së personave përgjegjës për t'u dëgjuar dhe/ose për të paraqitur qëndrimet dhe/ose argumentet, provat e tyre, si dhe/apo për të paraqitur mendime dhe shpjegime përpara përfundimit të procedurës administrative, në përputhje me nenet 10, 47, 87 dhe 88 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë". Njoftimi për zhvillimin e seancës u dërgua si në rrugë zyrtare, ashtu edhe elektronike. Megjithatë, në datën dhe orën e caktuar nuk u paraqitën as Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e personit përgjegjës për Programin e Transparencës, dhe as koordinatori për të drejtën e informimit, në cilësinë e personit përgjegjës për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Gjithashtu, nuk u komunikua asnjë arsye apo shkak për mosparaqitjen e tyre.

Gjithashtu, nga monitorimi *online* i përsëritur në datën 14.10.2026, rezultoi se Programi Institucional i Transparencës vijonte të ishte në mospërmbushje të detyrimit për

publikimin dhe përditësimin me informacion në rubrikat e këtij programi, në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe Urdhrin nr. 281/2025. Konkretisht, konstatohet mungesa e informacionit dhe përditësimit të tij lidhur me organizimin dhe funksionimin e Bashkisë, me të dhënat mbi transparencën dhe llogaridhënien ekonomiko-financiare, mbi informacionin lidhur me procedurat e prokurimit publik, mbi legjislacionin dhe aktet rregullatore, të dhënat mbi konsultimin publik, të dhënat mbi procesin e integrimit evropian, shoqërisë civile e strukturave komunitare, si dhe informacionit lidhur me veprimtarinë e Këshillit Bashkiak. Referuar Urdhrit nr. 281/2025 të Komisionerit, njësitë e vetëqeverisjes vendore kishin afat deri në datën 31.03.2026 për të reflektuar ndryshimet dhe për të bërë përshtatjen e Programit Institucional të Transparencës sipas formës dhe përmbajtjes, në përputhje me lidhjen nr. 1 bashkëlidhur Urdhrit, detyrim i cili i është bërë me dije Bashkisë Këlcyrë nëpërmjet shkresës nr. 72 prot., datë 09.01.2026.

E drejta për informim garantohet nga neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Programi Institucional i Transparencës është një nga instrumentet kryesore për garantimin e kësaj të drejte, duke mundësuar aksesin e publikut në informacionin zyrtar, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkese. Për këtë arsye, autoritetet publike kanë detyrimin ligjor jo vetëm të publikojnë Programin e Transparencës, por edhe të sigurojnë plotësimin dhe përditësimin e informacionit në rubrikat përkatëse, në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimet e kryera deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, Zyra e Komisionerit konstatoi se Autoriteti Publik vijon të mos ketë përmbushur detyrimin për publikimin dhe përditësimin e informacionit në rubrikat e Programit Institucional të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe modelin e miratuar me Urdhrin nr. 281/2025 të Komisionerit.

Pika 1 e nenit 18 të LDI-së parashikon se: *"Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni"*. Në shkronjën "ç/1" të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së parashikohet se: *"Mospublikimi i akteve brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të nenit 7 dhe mospërditësimi i kategorive të informacionit të Programit Institucional të Transparencës sipas pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë"*.

Në pikën 1 të nenit 19 të LDI-së parashikohet se: *"Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje administrative të parashikuara në ... shkronjën "ç/1" të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji"*. Referuar sa më sipër, përgjegjësia ligjore-administrative për shkeljen e konstatuar lidhur me Programin Institucional të Transparencës i atribuohet z. Klement Ndoni, Kryetar i Bashkisë Këlcyrë.

Po ashtu, në pikën 1 të nenit 8 të LDI-së, parashikohet se: "*Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër"*. Referuar shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 10 të LDI-së, krijimi, mbajtja, publikimi dhe përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe

përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 8 është një nga kompetencat dhe detyrat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

Në përfundim, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe nga monitorimi i vazhdueshëm i Programit Institucional të Transparencës, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se është konsumuar kundërvajtja administrative e parashikuar në shkronjën "ç/1" të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së. Për këtë shkelje, përgjegjësia ligjore-administrative i atribuohet z. Klement Ndoni, Kryetar i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Publik, në përputhje me nenin 19 të LDI-së.

Në përcaktimin e masës administrative përkatëse, për shkeljen e konstatuar, Komisioneri ka marrë në konsideratë kohëzgjatjen e mosrespektimit të detyrimit ligjor dhe vijimësinë e shkeljes së konstatuar, si dhe faktin se, pavarësisht afatit të dhënë gjatë hetimit administrativ për korrigjimin e mangësive, detyrimi ligjor vijon të mbetet i papërmbushur. Gjithashtu, në individualizimin e masës administrative është vlerësuar edhe historiku i shkeljeve të mëparshme, veçanërisht përsëritja e së njëjtës kundërvajtje administrative nga personi përgjegjës.

Në rastin konkret, Komisioneri vlerëson se vendosja e gjobës në kufirin maksimal prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh është e justifikuar, duke marrë në konsideratë edhe përsëritjen e së njëjtës kundërvajtje administrative nga personi përgjegjës. Konkretisht, me Vendimin nr. 64, datë 13.12.2023, Komisioneri ka vendosur më parë masë administrative ndaj z. Klement Ndoni, për shkelje të detyrimeve ligjore lidhur me Programin e Transparencës. Fakti që shkelja është konstatuar sërish, pavarësisht masës së mëparshme administrative, përbën një rrethanë që merret në konsideratë për individualizimin e sanksionit në vlerësimin e sjelljes së personit përgjegjës. Duke marrë parasysh këtë rrethanë, si dhe nevojën për të garantuar respektimin e detyrimeve ligjore dhe efektin parandalues të sanksionit, Komisioneri çmon se gjoba në kufirin maksimal ligjor është një masë e arsyeshme dhe proporcionale me rrethanat e rastit.

Në përfundim, duke vlerësuar tërësinë e rrethanave të rastit, veçanërisht përsëritjen e shkeljes nga personi përgjegjës, Komisioneri çmon se vendosja e gjobës në kufirin maksimal prej 50 000 lekësh është një masë e përshtatshme dhe proporcionale.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjën "dh" të pikës 2 të nenit 9/1, shkronjën "ç/1" të pikës 2 të nenit 18, pikat 1 dhe 2 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21 dhe nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Autoriteti Publik "Bashkia Këlcyrë", në zbatim të shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, të vërë në zbatim, të publikojë, të pasqyrojë, të përditësojë dhe të ndërlidhë

në Programin Institucional të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe duke pasur në konsideratë kufizimet e nenit 17 të tij, informacionin dhe dokumentacionin sipas formatit të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 13.11.2026.

2. Dënimin e z. Klement Ndoni, Kryetar i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e personit përgjegjës për Programin e Transparencës, për kundërvajtjen administrative të parashikuar në shkronjën "ç/1" të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
3. Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik "Bashkia Këlcyrë" të publikojë dhe përditësojë regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, bazuar në pikën 1 të nenit 8 të ligjit "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, dhe sipas modelit të Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 "Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuara", brenda datës 13.11.2026.
4. Masat e dënimit me gjobë shlyhet me këste mujore, në përputhje me nenin 21 të LDI-së. Gjobat ekzekutohen nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të këtij vendimi, sipas nenit 23 të këtij ligji.
5. Kundër pikave 1 dhe 3 të këtij vendimi, Autoriteti Publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.
6. Kundër pikës 2 të këtij vendimi, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 10279/2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Ky Vendim u shpall sot, më datë 28.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi